



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žulbe i Predstavke

Anr.458/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Milena Đerić kryesuese, Afijete Sada – Gllogjini dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Blerta Peci, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli ne Podujevë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Podujevë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 16.02.2021, mori këtë:

VE N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa A nr. 458/2021 e datës 14.02.2021, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli ne Prishtinë, e paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Podujevë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 16.02.2021.

A r s y e t i m

Me datën 14.02.2021, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli ne Podujevë, me të cilën pretendon se me datën 14.02.2021, rreth orës 10:00, në qytetin e Podujevës, në rrugën “Zahir Pajaziti” ndodhet një kombibus që mban posterin e kandidatit për deputet Visar Hoti nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në afërsi me të vogël se 100m nga Qendra e Votimit “Isa Boletini” në Podujevë. Sipas parashtruesit së ankesës me këtë veprim të vendosjes së posterit të kandidatit për deputet Visar Hoti në rrugën e lartshënuar, në afërsi nga Qendra e Votimit “Isa Boletini” në Podujevë, ka bërë shkelje të dispozitës së Nenit 8 pika b) të Rregullës Zgjedhore 13/2012 të KQZ-së.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale-fotografisë së bashkangjitur, që gjendet në shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 par. 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli pas vlerësimit të ankesës dhe provave të bashkangjitura në ankesë të cituara më lartë si dhe përgjigjes në ankesë dhe provat e bashkangjitura në të, erdhi në përfundim se pretendimet e ankuesit në ankesën e tyre, se subjekti politik ka thyer heshtjen zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, ku ka vendosur një kombibus që mban posterin e kandidatit për deputet Visar Hoti nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në afërsi me të vogël se 100m nga Qendra e Votimit “Isa Boletini” në Podujevë, PZAP-i i vlerëson si të pabazuara dhe të pa argumentuara në fakte dhe dëshmi konkrete pasi që ankesës në fjalë nuk i ka bashkangjitur asnjë dëshmi bindëse, përveç 1 fotografie.

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë nuk ka ofruar dëshmitë të qarta dhe bindëse për të vërtetuar pretendimet ankimore edhe pse barra e të provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, për të provuar pretendimet ankimore. Duke u nisur nga arsyet e theksuara më lartë, Paneli konstaton se nga ana e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, e cila ka parashtruar ankesën nuk mundë të pohohet me ndonjë provë materiale të shkeljes eventuale të dispozitave ligjore si vendi i kryerjes së shkeljes së pretenduar, gjegjësisht largësia e shkollës me vendin ku është fotografuar kombibusi me posterin e kandidatit në fjalë.

Prandaj, nga sa u tha më lartë ankesa vlerësohet si e pabazuar duke u bazuar në nenin 118, paragrafi 1, të LZP-së, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.458/2021 më datën 16.02.2021.

Kryesuese e Panelit

Milena Đerić



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa në kuptim të nenit 118.4 të LZP-së.